



BASHKIA
TIRANË

KESHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 89, datë 26.07..2017

PËR

“MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT NDËRMJET FONDACIONIT SHQIPTARO-AMERIKAN PËR ZHVILLIM, MINISTRISË SË ZHVILLIMIT URBAN, MINISTRISË SË KULTURËS DHE BASHKISË TIRANË “PËR PROJEKTIN E KRIJIMIT TË ZONËS TID NË PAZARIN E RI “PËR RESTAURIMIN DHE JETËZIMIN E PAZARIT TË RI DHE SHESHIT AVNI RUSTEMI NË TIRANË” DHE MIRATIMIN E TRANSFERIMIT TË TË ARDHURAVE VENDORE TË MBLEDHURA NGA BIZNESET E ZONËS TID, TEK ORGANIZATA TID, SI PJESË PËRBËRËSE E KËTIJ MEMORANDUMI MIRËKUPTIMI””.

Mbështetur në nenin 8, pika 2, nenin 9, pikat 1.1/1, shkronja (b), 1.3 dhe 1.5, nenin 28, nenin 34, nenin 54, shkronjat (d), (f) dhe (k) dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore;”, ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ligjit nr.8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” i ndryshuar; ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; vendimit nr. 59, datë 30.12.2015 të Këshillit Bashkiak “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Qytetin e Tiranës” i ndryshuar; me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Fondacionit Shqiptaro – Amerikan për Zhvillim, Ministrisë së Zhvillimit Urban, Ministrisë së Kulturës dhe Bashkisë Tiranë “Për restaurimin dhe jetëzimin e Pazarit të Ri dhe Sheshit Avni Rustemi në Tiranë”.
2. Miratimin e Aktit të Themelimit nr. 820 Rep, nr. 187 KOL/3, datë 10.03.2017 të organizatës jofitimprurëse, në formën e shoqatës “TID Tirana”, regjistruar me vendimin nr. 5613, datë 13.06.2017 të gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë.
3. Miratimin e hartës së zonës TID Tirana sipas Aneksit 1, bashkëngjitur Aktit të Themelimit të organizatës jofitimprurëse “TID Tirana”, duke përjashtuar tregjet e kësaj harte nga juridiksioni i Agjencisë së Administrimit të Tregjeve.
4. Transferimin tek organizata jofitimprurëse TID Tirana, të vlerës së të ardhurave të realizuara nga tarifave vendore të bizneseve që ushtrojnë aktivitet në zonën TID, si më poshtë:

- a. Të ardhurat nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave
 - b. Të ardhurat nga tarifa e zënies së hapësirës publike
 - c. Të ardhurat nga reklamat
5. Bashkia e Tiranës, çdo vit buxhetor planifikon në buxhetin e saj korrent transfertën për TID Tirana, në programin Zhvillimi Ekonomik dhe Punësimi, Aparati i Bashkisë, artikulli 604, bazuar në planin e të ardhurave nga tarifatat sipas pikës 4 që planifikohet të realizohen nga bizneset që ushtrojnë aktivitetet në zonën TID, sipas raportit nga DPTTV.
 6. Transferimi i të ardhurave realizohet çdo vit, i ndarë në dy periudha kohore, në muajin Korrik për periudhën Janar-Qershor dhe në muajin Janar të vitit pasardhës, për periudhën Korrik-Dhjetor, sipas raportit të paraqitur nga DPTTV-ja për arkëtimin e këtyre të ardhurave.
 7. Pavarësisht parashikimeve të pikës 5 të këtij vendimi, transferimi i të ardhurave për vitin 2017, do të bëhet me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, sipas përlogaritjes së planit të ardhurave, nga data e krijimit të organizatës jofitimprurëse TID Tirana deri më 31 Dhjetor 2017.
 8. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore për zbatimin e këtij vendimi.
 9. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI